

## PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATËS 28 MARS 2024

Kryesuesi I mbledhjes është: Zvëndëskryetaria e Këshillit Edlira Mitre

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi I mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes të mbledhjes: 30

Sekretari I Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh:30

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Zv. Kryetari Kletjon Kita dhe Drejtorë të Administratës

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:2

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Përshëndetje meqënëse kemi plotësuar kourumin jemi gati për të filluar mbledhjen, pa filluar miratimin e pikave unë do ju kërkoja ju si këshilltarë 1 minutë heshtje për katër figurat e shquara të qytetit tone që u ndanë nga jeta për z.Teodor Vaso, për z.Gjergji Suljoti, për z.Aleko Ballauri dhe për z. Ylber Merdani, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje. I përjetshëm kujtimi i tyre!

Fillojmë me rendin e ditës për miratimin e tij, nëqoftëse keni diçka ndonjë sygjërim apo pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Znj. Drejtuese kisha unë një pyetje, për të kuptuar me mire procesin e futjes në rendin e ditës të çështjeve pjesa më e madhe e çështjeve vijnë nga kryetari i bashkisë besoj tek sekretariati dhe kryesia e cila shpërndan më pas punën përkatëse , por megjithse këto çështje mund të vijnë dhe nga grupe këshilltarësh, mund të vijnë edhe nga iniciativa qytetare, mund të vijnë dhe nga komisionet. Pyetja ime është komisionet kanë në bazë të rregullores dhënien e pëlqimit për ti futur në rendin e ditës apo jo sepse me sa vura re në mbledhjen e fundit të komisioneve asnjë nga komisionet nuk e kishte kourumin këtë nuk e kam për të penguar punën e këshillit por besoj se është detyrë e jona ta bëjmë këtë punë sic duhet dhe të jemi prezentë në mbledhjet e komisionit sepse atje besoj se diskutimi është më teknik sipas çështjeve përkatëse, hyn në diskutime shikon janë të plota materialet apo jo nëse nuk janë të plota plotësohen në mënyrë që kur të vijnë në këshill të jenë të qarta çështjet, tani nëse këto komisione nuk mblidhen atëhere është e nevojshme ti bëjmë apo do i rregullojmë ti bëjmë siç duhet?

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Faleminderit Z.Pllaha të gjithë këshilltarët e dine që duhet të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve dhe këtë e kanë detyrim njësoj si mbledhjen e këshillit, nuk mund të flasim për ata që ishin, por ka raste që komisioni nuk mund të mblidhet për shkaqe të ndryshme por kjo nuk do të thotë që mbledhja nuk do të zhvillohet dhe vendimet nuk do të meren, duhet të meret parasysh dhe sygjërimi i Klajdit që duhet të marim përgjegjësitë që na takojnë dhe të marim pjesë në mbledhjet e komisioneve të japin sygjërimet e tyre për materialet dhe të vijë më i plotë në mbledhjen e këshillit.

Këshilltar E.Bregu: Përshëndetje duke mar shkas nga shqetësimi që ngriti Klajdi, unë nuk mendoj që ky diskutim ka të bëjë me faktin si e konsiderojmë ne që kanë dëshirë të vijnë këshilltarët në komision apo jo, ajo është një detyrim ligjor dhe shkelja e procesit e bën mbledhjen të pavlefshme.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Nuk zura dëshirën në gojë, zura përgjegjshmërinë.

Këshilltar E.Bregu: Nuk po merem as me përgjegjshmërinë as me dëshirën në momentin që procedura nuk zbatohet siç duhet vendimet e këshillit janë të pavlefshme nëqoftëse në bëmë një sy qor dhe një vesh shurdh dhe e lejojmë vendimet e këshillit marim formë të prerë por nëqoftëse në ankimojmë ato nuk marim formë të prerë dhe prefekti nëqoftëse zbaton ligjin duhet ta kthejë, që mos ndodhin situata të tilla unë mendoj që në një mbledhje nëqoftëse nuk ka qënë kourumi relacioni të vijë i saktë dhe komisioni të deklarojë që nuk është bërë kourumi dhe çështja nuk ka kaluar në komision, komisioni nuk jep pëlqimin miraton ose jo, nëqoftëse keni dyshime që jam shprehur gabim juristët, komisioni i çështjeve ligjore të marim në shqyrtim çështjen dhe të kthejë përgjigje.

Këshilltare A.Përmeti: Në lidhje me komisionin unë bëj pjesë në komisionin e ekonomisë dhe duhet të them që me marrjen e mandit ne nuk kemi pasur në asnjë mbledhje pjesëmarrjen që duhet të jetë minimalisht mbi 3 nga 5 që jemi ne, edhe në mbledhjen e fundit ishim kryetari, sekretari dhe unë të gjitha materialet kanë kaluar sipas rregullores, normalisht nëse nuk arrihet kourumi në komision diskutohet materiali direkt në mbledhjen e këshillit, Klajdi ka të drejtë sepse në komisionet ku ata janë pjesëmarrës ndonjëherë këshilltarët dhe vijnë dhe nuk vijnë, ne kemi qënë goxha aktive në këtë pjesë dhe kemi dhënë një kontribut goxha cilësor.

Këshilltar K.Pllaha: Më fal për ti dhënë një përgjigje definitive pyetjes, nuk e pengon fakti që nuk është mbledhur komisioni të kalojë për shqyrtim në këshill sepse sipas rregullores duhet të jape një rekomandim për miratim ose mosmiratim nëqoftëse nuk jep një pëlqim me votat në komision atëherë kjo çështje rikthehet edhe njëherë për shqyrtim në komision dhe kjo çështje shtyhet në mbledhjen e rradhës.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Meqënëse u përmend pjesa e vlefshmërisë, procedura e vlefshmërisë është e parashikuar në ligji për vetëqeverisjen vendore dhe në kodin për procedurën administrative dhe që vendimi i këshillit të jetë i ligjshëm duhet të ndiqen hapat që janë të parashikuara në ligji për vetëqeverisjen vendore, një material duhet të paraqitet 5 ditë para meret në shqyrtim nga këshilli dhe vendoset me shumicën e anëtarëve, pjesa e komisioneve është pjesë ose le të themi mënyra sesi ju e keni rregulluar që kjo të jetë sa më mirë për qasjen tuaj dhe keni ndarë disa komisione për të lehtësuar punën tuaj por nuk është se ja u kërkon ligji, vendimarrja në komision nuk cënon vendimarrjen në këshill.

Këshilltar L.Nako: Me këtë logjikë që thatë ju kush është roli i komisionit sepse i bie komisionet janë të pavlefshme?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Thashë nuk ja u kërkon ligji, ju keni ndarë disa komisione për lehtësimin e punës tuaj, për të funksionuar sa më mirë këshilli.

Këshilltar E.Nexhipi: Në çdo situatë ligji prevalon mbi çdo situatë ose praktikë që ne mund të kemi krijuar për të lehtësuar punën, pa diskutim nëse ne do flasim për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisionit apo dhe mbledhjet e këshillit diskutimi duhet të parashtrahet kush mungon?

Mos ndoshta duhet të parashikohen dhe ato penalitete të parashikuara në rregullore, mungesa e pagesës dhe kjo e zgjidh dhe e rregullon situatën them unë sepse pjesëmarrja në mbledhje nuk është tërësisht puna e këshilltarëve është dhe pjesëmarrja në komisione, atëherë le të shikohet mundësia nga kryesia bashkë me sekretariatën që të zbatohen ato penalitete për mos pjesëmarrje.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Nëse nuk kemi diçka tjetër e hedhim në votim rendin e ditës, kush është pro?

**Pika e 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

**Pika e 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES TË DATËS 29 SHKURT 2024.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Procesverbalin e keni me email.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Këshilltar E.Bregu: Më fal në lidhje me procesverbalet e datës 25 janar dhe 15 shkurt janë të miratuara sepse me sa dime ne ato u anuluan për miratim?

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: I kemi të miratuara kemi dhe numrin e votave.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Po i miratuam.

**Pika e 3 e rendit të ditës.**

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR PËR PERIUDHËN 1-29 SHKURT 2024.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Meqënëse unë jam pjesë e komisionit po vazhdoj, për muajin shkurt janë 64 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % e fondit të kushtëzuar këta janë vlerësuar me pikët nga administratori shtetëror për muajin shkurt është në dispozicion fondi prej 244 mijë e 590 lekë si 6% e fondit të kushtëzuar nga ky fond përfitojnë 64 familje të përzgjedhura me shumën 214 mijë e 707 lekë, po nga ky fond përfitojnë kompesim të energjisë elektrike 25 familje me shumën 29 mijë e 600 e 78 lekë, pagesa totale nga 6 % e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike plus energji është 244 mijë e 315 lekë dhe përfitojnë nga fondi i buxhetit vendor sipas kriterëve specifike 17 familje me fond 70 mijë e 709 lekë, lista e familjarëve është e bashkëngjitur në material ju ftoj ta miratoni.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika e 4 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E GRANTIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PËRFSHIRJE SOCIALE PËR NDRYSHIM” MIDIS BASHKISË KORÇË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM.**

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Edhe në këtë material kemi bonuse për të rinj të cilët marin pjesë në këto kurse e kemi miratuar bashkë me buxhetin afatmesëm të cilët marin pjesë në këto kurset e IT-së por këtë radhë bëhet fjalë për Kampin Veror Miqësia i cili realizohet çdo vit nga bashkia , është i disati vit që realizohet nga punojësi i bashkisë ju në material e keni të detajuar të gjithë anën buxhetore që kërkon ky projekt vlera totale është 1 milion e 200 mijë lekë është një projekt që përfshin ushqimi e fëmijëve, transportin, mjetet didaktike, nëqoftëse ekzekutivi na sqaron diçka më shumë.

Ekzekutivi M.Jorgji: Ky relacion vjen për miratimin e kështit të dytë që vjen nga Kombet e Bashkuara (UNDP), në kuadër të programit “Askush mos mbetet pas” është një projekt që po impementohet nga bashkia Korçë me mbështetje të (UNDP) , kësti i parë ka kaluar me vendimin e këshillit të bashkisë në shtator të vitit 2023 janë aktivitete të cilat përmenden më poshtë, krijimi i rrjetave lokale nga palët e interesuara, injecimi i një shërbim të lëvizjes për përmirësim dhe indentifikim të nevojave, trajnimi i nënave dhe fëmijëve dhe trajnimi i të rinjve për orientim drejt kërkesave të tregut, ky kësti i dytë ka të bëjë me realizimin e këtij projektit i cili do të zhvillohet në muajin korrik për 4 javë synimi është gjithëpërfshirja e fëmijëve kemi fëmijë me aftësi ndryshe, fëmijë në situatë rruge, vlera është e detajuar që ka të bëjë me transportin ditor për fëmijët, ka shërbimin për kampin veror që përfshin ushqim, pagesën orare për mësuesit dhe mjetet didaktike.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar E.Fejzullah: Përhëndetje, kisha një pyetje për zonjën, ka një numër limit pjesëmarrësish, ka një pagesë ekstra dhe a ka një klasifikim pjesëmarrësish apo jo?

Ekzekutivi M.Jorgji: Janë rreth 100 fëmijë që do të marin pjesë, kampi veror është falas që përfshin ushqimin, aktivitetet psikosociale.

Këshilltar E.Fejzullah: Si zgjidhen këta?

Ekzekutivi M.Jorgji: Zakonisht ne bëjmë shpalljen në fund të majit, përzgjidhen fëmijët në nevojë që i kemi nga Qendra Ditore të Fëmijëve, fëmijë me aftësi të kufizuar që ndjekin shkollën por dhe qëndrën ditore për fëmijë me aftësi të kufizuar me dëshirën e tyre vijnë rregjistrohen pranë drejtorisë të kujdesit social.

Këshilltare L.Alidinaj: Kjo vlera 1 milion e 800 mijë lekë është miratuar nga këshilli bashkiak dhe është realizuar doja të dija pak më shumë për trajnimet për nënat dhe fëmijët dhe trajnime profesionale për të rinjte drejt kërkesave të tregut, na flisni diçka më shumë për të sqaruar dhe ne dhe publikun.

Ekzekutivi M.Jorgji: Kemi pasur 100 fëmijë nga Qendra Ditore Për Fëmijë që kanë marrë këshillime psikologjike si dhe nënat e këtyre fëmijëve janë trajnuar dhe kanë marrë këshillime lidhur me

prindërimin, si dhe 15 të rinj janë trajnuar me atë që tregon tregu me menaxhimin e disa rjetve sociale, këto aktivitete kanë përfunduar tani kemi vetëm kampin veror që do të zhvillohet në korrik.

Zvëndës kryetaria e Këshillit E.Mitre: Nëqoftëse nuk ka pyetje tjetër e hedhim në votim?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika e 5 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR 2024-2026 “ NË BASHKINË KORÇË”**

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Meqënëse unë isha pjesë e konsultimit publik që bëri këshilltaria pranë bashkisë me drejtueset e kopshteve, ajo sot nuk mund të jetë sepse ndodhet e sëmurë i urojmë të shkuara, ne kemi miratuar edhe para 2 vitesh një plan si ky unë po flas pak shkurtimisht, në këtë plan do shërbejë si një platformë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse për arsimin parashkollor që konsiderohet një impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të bashkisë Korçë. E rëndësishme tek ky plan ishte rritja e rregjistrimeve në kopshte të djemve dhe vajzave, fuqizimi i strukturave të kopshteve bordet e prindërve, plani përfaqëson sfida të gjithë punës të parashkollorit, kjo listë përfshin vlerësimin e brendshëm të kopshteve, themelimin dhe fuqëzimin e organizmave të institucionit arsimor, komisioni i shëndetit dhe sigurisë. Plani ka objektiva të përgjithshme për rritjen dhe identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe për trajtimin e tyre, sepse numri i tyre për fat të keq është rritur, në lidhje me planin e përmirësimit do ju sygjeroja të shihni që është bërë një punë mjaft e madhe për rregullimin, përshtatjen e ambienteve të mësimin të kopshteve, trajnimi i stafit është në vazhdim, përmirësimi i infrastrukturës janë bërë ndërhyrje kuptohet që punë ka pafund, rikonstruksionin e tualeteve, rinovimin e ambienteve të brendshme, furnizimi i mjeteve didaktike u kërkuan nga drejtueset e kopshteve këto materiale sidomos për fëmijët me spektrin autik, nga institucioni i bashkisë dhe nga përfaqësuesja e projektit “Bashki Të Forta” ju dha një mbështetje këtyre fëmijëve, grupet e parashkollorit janë ngritur kryesisht për fëmijët që nuk kanë kryer kopshtin, grupi i tretë dhe parashkollor kanë të njëjtin nivel programi dhe ishte shqetësim sepse këto kopsht boshatisen dhe të shohim si do i rregullojmë , ky ishte një pan i detajuar dhe vlerat në tabela i keni me mijë lart që mos kemi keqkuptime, nëse keni pyetje unë do ju përgjigjem me aq sa kuptove nga ky takim.

Këshilltar L.Petri: Plani për mua është shumë ambicioz, si plan ky ka targete që duhen ndjekur kush është ekipi që do e zbatojë nëse ne si këshilltar nesër, pasnesër do duhemi të drejtojmë pyetje ku do të drejtohemi?

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Është plan që ndiqet nga institucioni i bashkisë sepse gjithë sistemi parashkollor është në juridiksionin e bashkisë, e dyta znj.Rudina Lako që është kordinatore për parashkollorin është në ndjekje të këtij plani, ajo është hartuese, mbikëqyrëse e planit dhe në fund ajo bën një relacion përmbledhës dhe nëqoftëse ne kemi ndonjë pyetje ajo është gjithmonë e gatshme të na

përgjigjet, gjithashtu dhe znj. Vilma Petro që është kordinatore e projektit Bashki të Forta është gjithashtu në ndjekje të këtij projekti kaq ambicioz.

Këshilltar L.Petri: Znj.Lako dhe znj.Petro mund të quhen si drejtuese të këtij projekti?

Kordinatore e projektit “Bashki Të Forta”V.Petro: (Nuk ka audio).

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Se këtu jemi pjesë e ekzekutivit, jemi ne këtu që duhet të mbrojmë materialin pastaj kalojmë tek të tjerët, Vilma e bëri shumë mire prezantimin më mire se Vilma nuk mund ta bënim por jemi këtu për tu përgjigjur pyetjeve, duhet të flasim njëherë ne si ekzekutiv pastaj nëse nuk kemi përgjigje për pyetjet mund të vazhdojë Vilma, për procedurë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Keni të drejtë, ju kërkohet ndjesë.

Këshilltar E.Nexhipi: Tani ky është një plan dhe nuk do të thotë që 100% ato që janë këtu do të zbatohen sepse një plan ka brenda pjesën financiare të përfshirë, unë dua të di hapat që janë ndjekur për hartimin e këtij plani kjo do të më interesonte sepse këshilli bashkiak është vendimarrës dhe ne sot mund të themi që nuk jemi dakort të bëhet në këtë formë, pra nuk është këshilli thjesht në rolin monitories.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Besoj se Vila ishte e qartë në atë që shpjegoi sesi ka arritur tek kjo pjesë dhe kush kanë qënë bashkëpunëtorët, drejtuese e këtij plani është këshilltarja e kryetarit Rudina, është ndërmarrja mbështetëse e arsimit, është drejtorja e kujdesit social, drejtorja juridike.

Këshilltar E.Nexhipi: Ky është një dokument strategjik dhe nuk mund të vijë vetëm me firmën e këshilltares për arsimin parashkollor, si dokument strategjik duhet të vijë nga grupi strategjik i bashkisë, pra unë mendoj se nëqoftëse nuk është urgjente të rishikohet nga grupi strategjik sepse ka vlera financiare dhe këshilli bashkiak ta miratojë dhe vlerat nuk janë pasqyruar siç duhet dhe për procedure mendoj që grupi strategjik duhet të firmoste atë dokument.

Këshilltare A.Përmeti: Është thjesht një plan pune dhe mbase ne e miratojmë si plan pune.

Këshilltar E.Nexhipi: Ne mund ta quajmë si të duam por ky plan ka vlera, po të ishte një dokument në parim po por në momentin që ka vlera duhet të rishikohet.

Këshilltare A.Përmeti: Edhe unë kisha disa elementë, ky është një plan dhe është hera e dytë që miratohet me sa kuptova, nga ana tjetër pavarësisht se thuhet janë 2245 fëmijë kapaciteti akomodues në kopshte do ta vlerësoja të kishim sa është numri i fëmijëve që duhet të ndjekin kopshtin pavarësisht se nuk është me detyrim, do ta vlerësonim të dinim se sa fëmijë do ishin dhe në kopshtet jopublike sepse duhet të ndërjegjësojmë prindërit që fëmijët të marrin pjesë në kopshtet publike, nga ana tjetër thuhet që janë 13 administratorë të vendosur përkatësisht në 6 rajone është lapsus të rregullohet sepse ka vetëm 3 rajone në qytetin e Korçës, gjithashtu thuhet që prindërit gjithmonë specifikohet për prindërit që rregjistrojnë fëmijët po për ata fëmijë që kanë në kujdestari jo prindërit por kanë gjyshërit apo familjarë të tjerë mendohet që dhe kjo të shtohet sepse nuk thuhet diku. Duhet tju japim prioritet edhe atyre familjeve që nuk jetojnë në Korçë me pashaportizim por realisht për shkak të punësimit të tyre duhet të vijnë në Korçë dhe fëmijët ti sjellin në një nga kopshtet më të afërta të punës të tyre, që mos ketë një ndikim social apo pakënaqësi dhe e fundit është pjesa ku lidhet me mbrojtjen kundër zjarrit, a kemi në çdo kopësht një plan të mbrojtjes kundër zjarrit sepse është për çdo institucion publik i detyrueshëm dhe a kemi sinjalistikë për këto kopshte ku janë hyrja, dalja elementet e emergjencës si fikse zjarri?

Shumë mire që do trajnohen të gjithë personeli, kaq kisha unë.

Këshilltare S.Dinellari: Në rradhë të pare doja të vlerësoja përgjegjësit që e kanë hartuar këtë plan duke u përpjekur të bëj dhe dallimin midis planit që është një vizion pune dhe strategjisë që kërkon veprim, me sa kam lexuar relacionin ky është një plan, ajo që unë nuk e gjeta tek ky plan është se cila është strategjia për të nxitur fëmijët apo prindërit që të cojnë fëmijet tek kopshtet publike dhe e dyta cilat janë strategjitë që do ndjekim ne për të ndalur bullizimin sepse kjo lidhet edhe me atë që përmendi znj. Ada nëse ne duam të rregjistrojmë fëmijët që vijnë nga zonat rurale apo nga komunitetet të ndryshme si mund të shmangim këto fenomene të bullizimit?

Këshilltar K.Pllaha: Znj. Drejtuese tha që është bërë një konsultim publik me drejtuesit e kopshteve mendoni që do jetë një taktikë e mire që të ftohen edhe anëtarët e këshillit në këto takime ose anëtarët e komisioneve përkatëse që sa here ka takime të tilla duhet të ftohet dhe këshilli?

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Komisioni i mirëqënies ishte i ftuar.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Me falni të dyja komisionet ishin të ftuara ai social dhe ai i arsimit, por pata një problematikë me emailin dhe tek komisioni i arsimit nuk ishte dërguar emaili kurse komisioni i çështjeve sociale u njoftua nuk e di a ishit prezentë.

Këshilltar K.Pllaha: Gjithsesi konsultime publike ka pasur e të tjera dhe unë mendoj se duhet të dërgohet ftesa për çdo takim konsultiv të gjithë anëtarëve të këshillit që të jemi më të informuar kjo e para si këshilltar, e dyta si prind në shtator do sjell vajzën në kopsht.

Kordinatorë e projektit “Bashki Të Forta” V.Petro: (Nuk ka audio).

Këshilltar K.Pllaha: Z.Nënkryetar faleminderit por unë po flisja nëse e vure re.

Këshilltare J.Romaçka: Bashkë me komentet e Adës dhe këshilltarëve të tjerë duke ja bashkëngjitur materialit patjetër shumë dashamirës ta miratojmë në mbledhjen e rradhës nëse nuk është urgjente.

Këshilltar K.Pllaha: Kjo është injorancë totale të ndërpresësh në mes të fjalisë por ska gjë vazhdoni ju.

Këshilltare J.Romaçka: Më fal nuk e vura re që po flisje, ideja është që ti bashkëngjitem këtij materialit idenë e Adës dhe gjithë propozimet e të tjerëve ta miratojmë mbledhjen e rradhës sepse vërtet sot duket pak i cunguar jo me një konotacion negative.

Këshilltare A.Përmeti: Më falni do ju kërkoja këshilltarëve mos i referohen emrit tim të japim mendimet e veta në lidhje me relacionin.

Këshilltare J.Romaçka: Nëqoftëse më dëgjove thashë të bëjmë një material së bashku me shkrim ja paraqesim si një lloj amedamenti duke ja bashkëngjitur projektin aktual, unë flas për veten time.

Këshilltare S.Dinellari: Znj. Përmeti mos e kishit për kolegen për mua thjesht për të dhënë përgjigje logjika ime qëndronte tek 2 fenomenet që ishin bullizimi dhe segregimi dhe meqënëse zonja tha mund të kemi fëmijë që vijnë nga zonat rurale kjo ishte logjika nuk ishte fare ideja e zonjës Përmeti.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Nuk ishte nevoja për kaq replikime nëqoftëse ju keni ndonjë mendim shprehni mendimin tuaj nëse jeni dakort e miratojmë nuk ka nevojë për kaq replikime.

Këshilltar P.Tollkuci: Unë mendoj që është një material voluminoz pavarësisht se unë nuk kam qënë pjesë e komisionit përkatës që ka përpiluar këtë material, sigurisht nga të gjitha ato që u diskutuan ishin në të mirë të këtij plani strategjik, unë nuk shoh arsye që ne të mos ecim drejt miratimit të kësaj pike dhe më pas në lidhje me pjesën se çfarë duhet për të plotësuar mund ta bëjmë shumë mire në mbledhjet e ardhshme të këshillit, faleminderit.

Këshilltar E.Nexhipi: Ekzekutivi të jape një mendim.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Tani për pjesën e pyetjeve dhe sygjerimeve që u dha nga këshilltarët nuk janë vendime që do i marrim tani do i futim apo jo në material për pjesën e bullizimit apo të tjera që u ngritën, këtu është hartuar një material dhe në momentin që është hartuar ky material është bërë ftesë kush ka shkuar kush nuk ka shkuar zgjidhni me sekretariatit këtë pjesë, nëqoftëse do kemi sygjerime të tjera për ta plotësuar këtë material atëherë patjetër që i futim edhe në mbledhjet e rradhës të këshillit për ta përmirësuar sepse ky është një plan dy vjeçar i cili gjatë gjithë kohës do ketë ndryshime, sygjerime kështu që jeni të lutur të gjithë këshilltarët ti paraqesni propozimet në këshill dhe ta bëjmë pjesë të planit strategjik të paraqitur, kështu mendoj unë. Tani kjo pjesa e mbrojtjes kundër zjarrit nuk është se duhet të jenë pjesë e planit strategjik se këto janë dhe detyrime ligjore.

Këshilltar K.Pllaha: Ka disa kriteret për liçensimin e kopshteve dhe çerdheve, kopshtet dhe çerdhet shtetërore asnjë nuk e mer liçensën nëqoftëse trajtohen njësoj si kopshtet private, jeni të ndërgjegjshëm për gjendjen që janë apo jo? Janë copë- copë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Pse Klajdi çfarë ke parë?

Këshilltar K.Pllaha: Nuk kanë shkallë emergjence, nuk kanë sistem mbrojtës nga zjarri, nuk kanë kushtet e mbrojtjes të fëmijëve merni kriteret e liçensimit nuk i plotësojnë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Klajdi më vjen keq unë të paktën kam shkelur një pjesë të madhe të kopshteve sepse më ka lidhur puna dhe nuk e shikoj gjendjen kaq keq sa thoni ju, është detyrim ligjor që të kenë mjetet e mbrojtjes nga zjarri patjetër, çdo kopësht që ka bërë rikonstruktimin është bërë me sistemin kapot.

Këshilltar K.Pllaha: Janë 31 kopshte që ndodhen në godinat e shkollave që nuk është e ligjshme.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Ti kthej një përgjigje Adës, ligji vet e përmban që rregjistrimin e bën ose prindi ose kujdestari ligjor, kështu që është me ligj ajo ndoshta duhet rregulluar pak atje me një tok fjalësh kujdestari ligjor. Tjetër pyetet për rregjistrimin sipas zonave, ky problem u ngrit edhe në takim, madje znj.Rudina tha që kur të dorëzohet dokumentacioni për rregjistrimi ajo do meret personalisht me ndarjen në mënyrë të barabartë sipas numrit të fëmijëve që i takon secilit kopësht.

Këshilltar E.Bregu: Pavarsisht parregullsive që janë ndjekur gjatë procesit dhe kryesorja ishte ajo që të mereshin vendimet me palët e interesuara gjë që do të bënte që ne të kishim një produkt më të mire, unë mendoj që në këto kushte që jemi nuk mund të bëjmë diçka më shumë por ta miratojmë me kushtin që në një kohë sa më të afërt të kryhen disa procedura për të marrë informacion nga palët e interesuara që të përmirësojmë projektin në fjalë dhe ta miratojmë përsëri në një moment të dytë, unë jam shumë dakort që të ketë pyetje dhe debate por ato duhet të jenë konstruktive dhe pa dale nga tema.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Meqënëse z.Bregu dha një ide të vyer mund ta miratojmë dhe gjatë rrugës sepse ju e dini që plani është 2 vjeçar dhe do ketë patjetër ndërhyrje, e hedhin në votim atëherë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 5



## **Pika e 6 e rendit të ditës.**

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.34, DATË 29.02.2024.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Meqënëse Anxhela po më thotë që 6 dhe 7 kanë lidhje me njëra-tjetrën sepse janë rikonstruksion, ti lexoj të dyja Erjon, diskutojmë pikën 6 komisioni ju lutem.

Këshilltar E.Nexhipi: Nga ekzekutivi ka erdhur një propozim për ndryshimin e një vendimi nr.34 të këshillit bashkiak datë 29.02.2024 për një pikë shtesë në grup prioritet e arsimit rikonstruksioni i shkollës “Sevasti Qirjazi” nga vlera 69 milion të ndryshojë në vlerën 71 milion e 241 mijë e 753 lekë, kjo lidhet me miratimin e fondit nga ministria e arsimit me këtë vlerë që sapo përmenda. Ju ftoj ta miratojmë si prioritet së pari pastaj si kontribut financiar.

Këshilltar L.Petri: Pyetja ime konsiston nëse ky rikonstruksion i shkollës “Sevasti Qirjazi” do marrë përsipër panelet e fotovoltaikeve apo jo , jemi dëshmitarë që të gjitha shkollat po rikonstruktohen siç jemi dëshmitarë që nuk po futet kjo frymë në mjedise publike në shkolla, private tani e ka kapur këtë gjë sepse është në dobi të tyre dhe besoj se duhet të praktikohet edhe në mjedise publike sepse sjell dobi në arkën tonë të përbashkët pasi kursen në faturat e energjisë, mund të na siguron ju lutem që kjo rritje e vlerës do ta përfshijë futjen e këtyre paneleve dhe pse tek rikonstruksioni i shkollave të tjera nuk është bërë kjo gjë.

Këshilltar E.Nexhipi: Ndryshimi i vlerës ka të bëjë me ndryshimin e sistemit si llogariten aktualisht çmimet nuk është më me çmime fikse por me sistem dinamik dhe për shkak të rezultatit që ka dalë në momentin që është miratuar fondi është kjo vlerë, nuk ka të bëjë me ndryshimin e projektit nga ana strukturore, për sa i përket faktit që pse nuk janë përfshirë këto panele tek shkollat e tjera nuk lidhet me mungesën e dëshirës por lidhet me mundësinë financiare dhe përfitueshmërinë, mos ngatërojmë konsumin që mund të ketë një fabrikë ose një biznes me konsumin që ka një shkollë.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Tani pjesën e vlerës e sqaroi Erjoni, kurse për pjesën e këtyre paneleve kjo shkollë i ka të montuara nga një projekt tjetër që ka qënë projekt pilot dhe kjo shkollë i ka të montuara.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika e 7 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E KONTRIBUTIT FINANCIAR TË BASHKISË KORÇË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE “SEVASTI QIRJAZI” ME CIKËL FINANCIIMI 2024-2025.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Atëherë Ministria e Arsimit dhe Sporteve me shkresën datë 11.03.2024 në njoftimin për shpalljen fitues për projektet e aplikura ndaj Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve ka shpallur fitues projektin e bashkisë Korçë lidhur me rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi” vlera e financimit do të jetë 71 milion e 241 mijë e 753 lekë nga të cilat 80 % do jetë kontributi i kësaj ministire

dhe 20% i bashkisë, vlera e cila i kërkohet këshillit të miratohet është e ndarë 10% në vitin 2024 dhe 10 % në vitin 2025 kjo përfshin pjesën e rikonstruksionit, ndërhyrjen dhe kolaudimin e ndërhyrjeve, në total ekzekutivi i kërkon këshillit të miratojë kontributin 7 milion e 857 mijë e 520 lekë, ju ftoj ta miratoni.

Këshilltari A.Përmeti: Të shtoj dhe diçka meqënëse u bë pyetje në komision ku konsiston rikonstruksioni dhe ajo lidhet e pjesën e brendshme të godinës totalisht me sistemin e dritareve por dhe me gjithë mobilimin si dhe mjedise për bibliotekën që do kenë edhe ndriçim natyral kështu që na u dha shpjegimi nga ana e urbanistikës që është një vlerë e shtuar për këtë shkollë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Nëse nuk kemi pyetje e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika e 8 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 NË NIVEL PROGRAMI.**

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Komisioni ju lutem.

Këshilltari A.Habip: Në zbatim të udhëzimit 3 datë 28.02.2024 për përgatitjen e programit buxhetor afatmes përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 bashkia ka përgatitur tavanet buxhetore të shpenzimeve pra kufirin e sipërm të parave që mund të shpenzohen, këto tavane janë ndërtuar për 11 programe që përfshijnë 27 funksione, lidhur me këto tavane janë parashikuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat të cilat janë parashikuar me një rritje 1% nga viti, transferat e pakushtëzuara të përgjithshme është parashikuar një rritje me 5% për vitin 2025 dhe 2026 ndërkohe që për vitin 2027 rreth 4% më shumë se viti 2026, transfertat e pakushtëzuar për pagat nuk do të ketë ndryshime, ndërsa transfertat e pakushtëzuar sektoriale do të jetë njësoj për vitin 2025 krahasur me viti 2024 dhe do të ketë rritje nga 1% në vitet 2026-2027.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Kemi pyetje, nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 6

#### **Pika e 9 e rendit të ditës.**

**PËR RISHQYRTIMIN E V.K.B-SË NR.32 DT.29.02.2024 “PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT TË PRONAVE, INDETIFIKUAR SI PASURITË ME NR.2/12 VOL.27 FAQE 167; NR.2/539-ND, VOL.27, FAQE 168; TRUALLI NËN**

NDËRTESEËN NR.2/708-N1, PJESË E PASURISË NR.2/10, VOL.33, FAQE 19 SIPAS HARTËS BASHKËNGJITUR”.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Komisioni ju lutem.

Këshilltar K.Kocibelli: Përshëndetje të gjithëve kjo ka të bëjë me vendimin e këshillit bashkiak i cili është miratuar datë 29.02.2024 me numër 32 në fakt ky u miratua me shumicë votash por kur i është dërguar institucionit të prefektit ai e ka rikthyer atë për shkak se sipas nenit 54 pika e kërkon një shumicë prej tre të pesta, në këto kushte komisioni ja sjell sërish këshillit për miratim.

Këshilltar E.Bregu: Herën e kaluar kur kjo çështje u miratua nga këshilli i bashkisë ne kërkuam që të ndërpritej seanca të mbledhjes komisioni dhe të merej në shqyrtim ligjshmërinë e votimit sepse nuk ishte bërë me tre të pestat dhe na u tha që nuk ka nevojë për tre të pestat sepse këshilli nuk bën miratimin por jep pëlqimin, ndaj gjej rastin që të konfirmoj edhe njëherë që këshilli nuk jep pëlqime as autorizime si ato që i keni dhënë kryetarit të bashkisë, këshilli ose miraton ose refuzon një projektvendim.

Këshilltar E.Nexhipi: E vërtetë është ajo pjesë deri në momentin që ne e diskutuam në komision dhe unë prap i qëndroj vendimit që ne nuk bëjm tjetërsim prone me këtë vendim që marim këtu, tjetërsimi i pronës bëhet nga këshilli i ministrave dhe për këtë procedurë pika e nenit që i referohet prefekti për mua nuk qëndron, prandaj ka të drejtë ta kthejë njëherë për here të dytë jo e çon në gjykatë, prefekti nuk është institucioni që jep verdiktin final.

Këshilltar K.Kocibelli: Na citon ligjin për transferimin e pronësisë ndërkohë janë dy interpretime të ndryshme pëlqimi është tjetër dhe transferimi tjetër gje, nuk ka 1 ligj që jepet pëlqimi apo transferimi në këto kushte unë mendoj që vlerësimi që i ka bërë institucioni i prefektit është i gabuar, po ta njohim mirë kodin civil dhe kodin e procedurës civile do shohim rastet e transferimit të pronësisë janë raste të caktuara, ne mund të japim pëlqim për këto prona por transferimin e bën institucioni përkatës.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Unë kam materialin e mbledhjes të kaluar dhe atje citohet dhënien e pëlqimit dhe gjithashtu në materialin e prefektit citohej që këshilli ka të drejtë për dhënien e pëlqimit, kështu që unë nuk shoh që ky votim ishte i gabuar.

Këshilltar P.Tollkuci: Unë mendoj që këshilli është një vend ku mund të bëhet debat por ky material edhe sipas z.Kristiano Kocibelli si anëtar i komisionit të ligjve besoj se janë shteruese dhe unë mendoj që thjesht ne ta lemë në votim dhe çdokush të votojë sipas dëshirës të vet.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Përsëri do e merni fjalën për të njëjtën çështje?

Këshilltar E.Bregu: Regullorja e këshillit të bashkisë dhe ligji për pushtetin vendor e përcakton qartë këshilli i bashkisë nuk jep pëlqime, autorizime vetëm miraton ose refuzon, keqinterpretimet e ligjit dhe termat që përdoren në mënyrë abuzive nuk duhet të pranohen në këtë sallë.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: (Flet pa mikrofon, nuk ka audio).

Këshilltar L.Petri: Unë mendoj që diskutimi po kalon në nivel fjalësh sigurisht këto kanë rëndësinë e vet por për mua po ja shtrojmë rrugën Këshillit të Ministrave që të bëhet ky tjetërsim prone dhe unë mendoj që autoriteti i prefektit është autoritet dhe nuk duhet të hyjmë në diskutime e ka mire prefekti apo jo, institucioni i tij është autoritet ai ka sjellë këtu një relacion.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Edhe ne jemi autoritet mos ja ulni vlerat vetes.

Këshilltar L.Petri: Sigurisht që jemi autoritet por jemi para faktit që prefekti thotë që duhet me tre të pestat ai votim, pra votimi që është bërë mbledhjen e kaluar është i gabuar, unë propozoj që ne të kalojmë në rivotim dhe të shohim nëse e arrijmë kourumin.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Fjala për z.Fejzullah.

Këshilltar E.Fejzullah: Ajo që ne na bën konfuz është do votojmë dhe njëherë të njëjtën gjë apo do të votojmë ka të drejtë prefekti apo këshilli?

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Do rivotojmë materialin.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Që ta lemë në fuqi vendimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 5

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Faleminderit miratohet dhe ky material, kalojmë në kërkesa ankesa të qytetarëve, së pari po ju lexoj një kërkesë drejtuar këshillit bashkiak e ka bërë këshilltarja e këshillit znj.Laureta Alidinaj.

Të nderuar Këshilltarë kërkoj miratim tuaj në lidhje me dy pallate dykatëshe në lagjen 6, rruga “Pandi Krëku” të cilat janë në gjendje të rënuar sidomos katet e dyta dhe shkallët e brendshme, gjendjen e tyre do e pasqyrojmë me foto ku jetojnë familje të komunitetit rom dhe egjyptian, për të kryer një projekt me personelin e bashkisë Korçë për të përcaktuar një vlerë reale dhe financuar me donator pasi në këto dy pallatet janë kryer ndërhyrje dhe nuk mund të përfitojnë nga projekti që është në zbatim sepse janë trajtuar, ka bashkëlidhur foto që i ka marrë në pallati që bëhet fjalë, kërkesën ne do ja drejtojmë patjetër zyrës të urbanistikës dhe zyrës të strehimit.

Këshilltar E.Nexhipi: Mund të bëj një pyetje, kjo zonë apo këto pallate nuk janë përfshirë në rikonstrukcioni i banesave në nevoja të veçanta apo i kanë prishur prapë?

Këshilltare L.Alidinaj: Nuk i kanë prishur por nuk i kanë trajtuar në të gjitha punimet.

Këshilltar E.Nexhipi: Më fal tani sepse duhet të jemi social jemi socialë, të tregojmë vëmendje por jo të nxisim dembelizmin duhet të jemi në një ekulibër.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Kërkesë për mirënjohje për Benol Progrin dhe vëmendje institucionale për benonizmin. Është një material i dërguar nga z.Lazjon Petri i cili ve në pah ato vlerat e këtij zotërisë në vitin e erët 1997 i cili mbrojti me vetëmohim Parkun “Rinia” që e gëzojmë sot.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Për këtë pjesë duhet të presim vendimarrjen e Këshillit të Ministrave.

Këshilltar E.Nexhipi: Në dijenin time edhe para disa vitesh ka pasur një propozim edhe nga partia socialiste por kishte dhe arsye të tjera që nuk u avancua ishte me duket me Emblema e Artë sepse këshilli bashkiak ka dy mundësi ose qytetar nderi, por është nderuar me Emblema e Artë, unë do i sygjeroja këshillit sa të bëhen këto procedurat sepse nuk e dime sa zgjatin, ta nderojë me një çertifikatë mirënjohje për kontributin që ka dhënë ky person për ruajtjen e parkut.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Kërkesa tjetër është për mbështetje financiare, Kryetarit të Bashkisë z.Sotiraq Filo, Kryetares të Këshillit.

Këshilltar L.Petri: Më fal për procedurë tek kërkesa që parashtruat nuk ishte vetëm kërkesa për dhënien e mirënjohjes dhe shpalljes qytetar nderi të zotit në fjalë por ishte dhe një kërkesë që të shkelet procedura brenda mundësive për të hapur një konkurs artistik që mund të ndërtohet një instalacion duke mishëruar këtë akt heroizmi të personit në fjalë por mendoj që na takon që ne të reflektojmë mbi atë çfarë ka ndodhur dhe mund ti shkonte shumë mire në parkun “Rinia”.

Këshilltar E.Nexhipi: Këtë dhënien për personat sa janë gjallë edhe Enver Hoxha nuk e bëri mos kalojmë në këto ekstreme të vlerësimit, deri në momentin që po diskutonim për një njeri që për një arsye apo për një tjetër sepse ishte puna e tij apo se kishte dëshirë ta ruante hajd e vlerësojmë por tani mos kalojmë në ekstreme ta bëjmë dhe monumente.

Këshilltar L.Petri: Unë e çmoj shumë arsyetimin e kolegut parafolës dhe pse ndonjëherë vë re që ai dëgjon ato që do të degjojë, në kërkesën që kam parashtruar nuk thuhet në asnjë moment që ne të bëjmë një monument për zotërinë, unë kam shprehur që ne të kemi mundësinë të shpallim një konkurs artistik për zotërinë në fjalë nuk thuhet në asnjë vend që ne do bëjmë portretin e zotërisë atje.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Kalojmë tek kërkesa tjetër siç e lexova është për mbështetje financiare, drejtuar Kryetarit të Bashkisë z.Sotiraq Filo, Kryetares të Këshillit znj.Ana Verushi këshilltarëve, universitetit “Fan Noli” në fillim të këtij viti do marrë pjesë në lojrat Europiane duke u përfaqësuar me ekipin e futbollit, nuk po zgjatem domethënë bëhet një përmbledhje e ekipit të univërsitetit i cili do përfaqësojë universitetin tonë në këto lojra europiane po ju drejtojmë këtë kërkesë për mbështetje financiare nga ana e bashkisë Korçë për të bërë të mundur pjesëmarrjen sa më dijnitoze të ekipit që përfaqëson qytetin tonë, kanë vënë një tarifë 75 euro për çdo person në ditë qëndrimi, përveç kësaj një taksë pjesëmarrje me vlerë 50 euro, kështu që kërkojnë një mbështetje nga bashkia në vlerë 7 mijë euro pjesën që mendojnë ata që e mbulon bashkia dhe pjesën tjetër e mbulojnë vetë.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Ne këtë kërkesën e universitetit e kemi marrë dhe po e shqyrtojmë por realisht jemi dashamirës për ta mbështetur univërsitetin në të gjitha fushat, por puna është që ne nuk e kemi funksion pjesën e arsimit të lartë, megjithatë ne do e shqyrtojmë këtë pikë me drejtorinë juridike dhe drejtorinë e financave dhe nëqoftëse do kemi ndonjë hapësirë ligjore për ti ndihmuar patjetër do jemi të hapur për të ndihmuar dhe për të marrë pjesë ekipi i futbollit, kërkesat që i janë drejtuar bashkisë do i kthejmë një përgjigje me shkrim ashtu siç është dhe procedura për kthimin e përgjigjeve.

Këshilltar K.Pllaha: Për procedurë përgjigjet që ju kthehen me shkrim gjithë këshilltarëve, dhe kërkesat që ngrihen nga këshilltarët mund ti vihen në dispozicion gjithë këshillit e kam kërkuar edhe njëherë tjetër këtë gje dhe tjetra nëqoftëse kërkesat vijnë në formën e një projekt propozimi na është thënë që ekzekutivi e mer në shqyrtim dhe ndërton mbi të një projektakt që mund ta kalojë pastaj për vendimarrje në këshill, janë marrë në shqyrtim këto pra ka një afat ligjor sepse kërkojmë një përgjigje për çdo kërkesë që është bërë, duhet një përgjigje me shkrim dhe duhet të vihemi në dijeni edhe ne si këshilltar?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica:( Flet pa mikrofon, nuk ka audio).

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Gjithmonë flisni në përgjithësi, thoni për kë edhe ju japim përgjigje.

Këshilltar K.Pllaha: Ja ta them unë janë dy gjëra të ndara, një janë kërkesat e qytetarëve i drejtohen këshillit pavarësisht se vendimarrja mund të jetë pjesë e ekzekutivit besoj se përgjigjia që jep ekzekutivi duhet të na vihet në dispozicion edhe ne.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Më thuaj cila nuk të ka erdhur një kërkesë nga ato që kemi pasur këto kohët e fundit, të zonjës që ka erdhur disa here këtu në mbledhje e ka marrë përgjigjen këtu nga ekzekutivi dhe ju keni qënë të informuar.

Këshilltar K.Pllaha: Përgjigjen zyrtare që mer nga ekzekutivi, përshembull ja kjo çështja e universitetit kur të vijë përgjigjia na i dërgoni dhe ne. E dyta kur kërkesat vijnë si projekt propozime nga këshilltarët ato kalojnë nëpërmjet sekretariatit tek ekzekutivi, ekzekutivi nëse e shikon të arsyeshme harton një plan punë se çfarë kosto kanë mbulojnë apo jo ato kosto dhe duhet të kthejë një përgjigje nëse është e realizueshme apo jo, përshembull unë kam dorëzuar vetë një kërkesë por përgjigje zyrtare nuk kam marrë më është thënë në mbledhje që do e shqyrtojmë dhe po pyes ka një afat kohor për këtë.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Do ta ndjek unë, në dijenin time është tek kryetari por do ta ndjek unë dhe do ju kthejë një përgjigje, z.Bregu disa kërkesa që ka sjellë në dijenin time ka marrë dhe përgjigje ose nga mua ose nga protokoli.

Këshilltar K.Pllaha: Unë mendoj që përgjigjet që ju jepen qytetarëve është mire që tju vihen në dispozicion të gjithë këshilltarëve.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Qytetarët që kanë qënë këtu ju keni qënë prezent dhe e keni marrë përgjigjen, nëse doni dhe përgjigjen zyrtare do ja u vemë në dispozicion.

Këshilltar P.Tollkuci: Në lidhje me atë që po fliste parafolesë z.Klajdi edhe unë i jap të drejtë që ne si këshill ta kemi si informacion, gjithsesi nëqoftëse nuk ka ndodhur deri tani ajo përgjigje që jepet nga ekzekutivi unë besoj që në shkresë ti vendoset edhe këshillit bashkiak dhe ne të kemi një kopje të atashuar, që edhe ne të kemi një përgjigje edhe ta mbyllim këtë diskutim, faleminderit.

Këshilltar E.Nexhipi: Ka një fakt që gjithë këto letra këtu nuk janë prekur me dore tani nëse pretendojmë që 41 këshilltarë të marin përgjigje të një kopje për mua është shumë, kush ka interes për një përgjigje le të interesohet dhe le ta marrë mos i bëjmë procedurat më të vështira seç janë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Unë di rastin e asaj zonjës që kërkonte përgjigje dhe ne si komision i mirëqënies e kemi marrë përgjigjen që i është drejtuar nga ekzekutivi për atë dhe ne si komision ja kthyhem përgjigjen.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me çështjen në fjalë këtu nuk bëhet diskutimi nëse do printojmë 5 fletë më shumë apo më pak edhe këto letrat që janë këtu janë tepër sepse mungojnë 10 këshilltarë ndërkohë që siç tha dhe Klajdi njoftimi bëhet edhe elektronikisht, këto diskutime janë pa vlerë, diskutimi që Klajdi ngriti dhe ne e mbështesim është a është procesi që ne duhet të vihemi në dijeni ky është thelbi sepse i keni kthyer diskutimet në nivel qesharak që nuk ja vlen të diskutosh.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Kemi një ankesë që ka bërë z.Elvin Bregu ka paditur këshillin e bashkisë i është drejtuar prefektit për mbledhjen e zhvilluar në datën 29 dhjetor 2023.

Këshilltar E.Bregu: Unë mendoj që kjo nuk është një çështje që i përket këshillit të bashkisë, kërkesa është bërë sipas udhëzimeve të financës që këto drejtohen në këtë formë sepse ne nuk dime të japim përgjigje, pasi kemi bërë kërkesën kemi marrë një përgjigje që refuzohet sepse e ke bërë individualisht e të tjera, tani ligji thotë që këshilltarët veprojnë në bazë të funksionit të tyre nuk veprojnë për personin e tyre sepse Erjoni tha rradhën e parë unë këtë vendimin që po mar për këshilli e qarkut nuk po e çoj në shtëpi po e kërkoj për arsye institucionale dhe ankimi im ka të bëjë për arsye institucionale, trajtimi i çështjes si personale nga ekzekutivi i bashkisë është totalisht i gabuar dhe i qëllimshëm, ligji thotë që unë aktin e mar si këshilltar.

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Duhet vendimarrje e këshillit.

Këshilltar E.Bregu: A kam të drejtë të ankimoj vendimin në gjykatën administrative?

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Po ke të drejtë si këshilltar.

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse unë veproj si këshilltar buxheti i bashkisë i parashikon shpenzimet apo i parashikon vetëm për kryetarin e bashkisë?

Drejtoria Juridike A.Qeramixhi. Edhe kryetari i bashkisë e bën si individ nuk vete si kryetari i bashkisë.

Këshilltar E.Bregu: Unë e paraqita kërkesën tek financa dhe ata nuk duan të veprojnë sepse kështu doni ju si ekzekutiv, këtu nuk diskutohet për vlerën e pagesës por diskutohet për procesin unë e kam bërë ankesën si këshilltar në funksion të detyrimeve të mija ndaj qytetarëve apo e kam bërë si individ që ju doni ta keqinterpretoni?

Këshilltar K.Kocibelli: Siç funksionon këshilli bashkiak me një rregullore ashtu funksionon edhe sistemi gjyqësor me një rregullore, për sa i përket shpenzimeve gjyqësore qoftë person fizik qoftë juridik gjykata në fund vendos edhe për shpenzime gjyqësore si ndahen ato dhe në rast se gjykata vendos që shpenzimet gjyqësore ti kthehen atëherë është personi juridik që detyron të paguajë këtë.

Këshilltar E.Bregu: Kjo nuk ishte çështje për këshillin në rradhë të parë dhe e dyta kur u miratua buxheti në 29 dhjetor 2023 i cili u bë pa konsultime në atë buxhet ju keni parashikuar për këshillin e bashkisë shpenzime për të mbajtur kontakte me votuesit me banorët e zonës 100 mijë lekë për shpenzime karburanti për 41 këshilltarë pra do të thotë që ekzekutivi nuk do që këshilli të funksionojë do që të jetë inekzistent thjesht të miratojë atë që sjell ekzekutivi pa debate, pa informacion, pa kundërshtuar ju nxirni çdo pengesë të tillë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Kërkesa e fundit që ka erdhur me shkrim, ka erdhur nga një banore e bashkisë Korçë.

E nderuar znj.Kryetare Ana Verushi, të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak, unë që po ju shkruaj jam një qytetare e Korçës Kresilias Agolli nuk po ja u them këto hollësitë, sapo kam mbushur 18 vjet jam nxënëse e vitit të fundit të gjimnazit dhe ajo tregon se nuk është e mundur të punojë sepse aktualisht është nxënëse dhe mamaja e saj Alma Iljaz është me një shumëllojshmëri sëmundjesh por me e rëndësishmja është ajo e shikimit që po shkon drejt verbimit, kërkon një ndihmë financiare nga bashkia ka bashkëngjitur këtu gjithë dokumentacionin çfarë ka bashkëngjitur edhe dëshminë e invaliditetit, epikrizat e doktorëve po ja përcjellim dhe këtë ekzekutivit ndoshta gjendet një mënyrë për ta ndihmuar.

Këshilltar E.Nexhipi: Një propozim që ka erdhur nga biznesi, është një diskutim i hapur tashmë dhe në mediat sociale për bërjen e një dite pushim të detyrueshëm për bizneset e tregëtisë dhe shërbimit për qytetin e Korçës, me sa di unë nga bashkia është bërë dhe një kërkim tregu me pyetsorë dhe ka rezultuar që është i pranuar nga biznesi por nuk po shikojmë realizimin të na vijë materiali që ta miratojmë nuk e di ku pengohet, nga interesimi që kam pasur unë edhe me administratën e bashkisë kishin këtë pjesën e roganizimit dhe detyrimit të themi se tjetër gjë është miratimi si rregull dhe tjetër gjë detyrimi për ta zbatuar rregullin.

Qytetari:Përsëritet njëherë për sa i përket ditës pushim punëtori e kërkon vetë që një ditë të jetë pushim, 90 % e bizneseve sepse unë kam biznes dhe km 27 vjet që merem me këtë punë e duan një ditë pushimi të paktën ditën e diel, dhe në Greqi dhe në Maqedoni ditën pushim e ka bërë qeveria qendrore ka mundësi që ta bëjë bashkia?

Këshilltar K.Kocibelli: Tani po ta shohim kodin e punës e shohim që e diela atje është pushim për të gjitha institucionet për sa i përket bizneseve nuk ka ndonjë qëndrim të unifikuar unë mendoj se kjo është e përcaktuar tek pjesa e orareve të detyrueshme të punës që ka secili individ secili prej nesh sipas kodit të punës nuk mund të punojë më shumë se 42 orë në javë, pra po ta shohim kodin e punës e ka të rregulluar pjesën e orareve sesa do të punojë një individ një biznes mund ta rregullojë e disa nëpunës pjesën e menaxhimit të biznesit të tij, ndërsa për sa i përket çështjes të vajzës që kishte probleme unë do të sygjeroj që ekzekutivi të shërbejë si udhë lidhëse midis vajzës që ka bërë kërkesën edhe shoqatave apo fondacioneve të cilët ju vijnë në ndihmë personave në nevojë, duke qënë se në Shqipëri kanë qënë disa shoqata që kanë treguar raste të ngjashme të cilat kanë qënë edhe të sukseshme, unë mendoj që është e lehtë për të gjetur kontakt me institucione të tilla për të shërbyer si udhëlidhëse sepse institucionet e kanë pak pengesë ligjore për të bërë financime të tilla.

Këshilltare L.Alidinaj: Për rastin e pare edhe unë e mbështes për ta financuar sepse ishte vajzë e vogël.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Për financimin që kërkon vajza duhet të shikohen mundësitë por sa here që ka erdhur dhe ka pasur problem shëndetësore nga bashkia është mbështetur edhe nga buxheti i shtetit.

Këshilltare L.Alidinaj: Nuk e vë në dyshim që është ndihmuar por nëse ka ndonjë mundësi për më tepër meqënëse është për arsye shëndetësore të ndihmohet, ndërsa për rastin e dytë dhe unë si këshilltare e kam kërkuar për ditën pushim për të gjitha bizneset nuk e di nëse keni ndonjë informacion ku çalon situata të na jepni dhe ne një sqarim për tu informuar deri ku është çështja e zgjidhjes.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Tani për sa i përket pjesës të ditës pushim pavarësisht se kemi kërkesa të shumta e kemi nisur si iniciativë kemi bërë dhe një sondazh dhe ato përgjigje i kemi përmendur edhe këtu në mbledhjet e këshillit por edhe në takimet që kemi bërë për buxhetin apo takimet që kemi bërë për biznesin për taksat dhe tarifavat vendore dhe kjo ishte dhe një nga pikat dita pushim, tani dita pushim siç e thane dhe zotërinjtë në vendet e tjera të rajonit nuk është iniciativë që meret nga bashkia por meret me vendim qeverie për të gjitha llojet e bizneseve por meqënëse ne kishim disa here kërkesa ne thamë të ecim dhe të ndjekim gjitha problematikat por nuk është qaq e thjeshtë të themi dita pushim e diela nëse do ju lexoj të gjithë të anketuarit unë për të gjitha bizneset edhe dita e dielë është e diskutuar disa e duan të dielë disa e duan të martë në varësi të llojit të aktivitetit por nuk është kjo çështje kryesore nëse është e diela apo e hëna, çështja është midis biznesit të madh dhe të vogël tani po marketet nëse e pyesim një market lagjeje e do ditën pushim të dielë ai do thotë jam shumë dakort ndërsa biznesi i madh e ka të zgjedhur ditën e dielë pushim sepse ai ka shumë punojës dhe i ka të zgjidhura ditët pushim pasi një punojës e ka pushim ditën e hënë tjetri të martë dhe nuk më leverdis ta mbyll supermarketin, nëse ne nuk mbyllim dot supermarketin do mbyllim marketin çfarë përfiton subjekti, edhe furrat e bukës ka shumë biznese të vogla që e kërkojnë një ditë pushim që ne qytetarët e Korçës por dhe gjithë Shqipërisë nuk jemi mësuar ta marrim bukën sot edhe ta hamë pas dy ditësh, biznesi i madh thotë unë e kam të zgjidhur atë pjesë sepse kam gjithë ata punëtorë dhe i alternoj, po marrim dyqanet në pedonale një pjesë është biznesi i vogël që duan ta kenë pushim dhe pjesa tjetër janë biznesi i madh që nuk duan ta kenë, tani janë shumë gjëra të panjohura që po na dalin atje dhe duhet të flasim për një rregullore, ne jemi munduar që dhe me bashkinë e Kosturit dhe me dhomën e tregëtisë të na jape disa gjëra si i kanë të përcaktuara ata me vendime dhe si i kanë oraret dhe nuk është një iniciativë që e duam pushim dhe e kanë pushim sepse ka shumë gjëra nga mbrapa që do dëmtojnë bizneset sepse ne i kemi bërë të gjitha konsultimet me të gjitha llojet e aktiviteteve dhe na kanë dale shumë gjëra të panjohura, në pedonale 4-5 argjendari thonë jemi për ditën pushim por e duan ditë të ndryshme, para se ne të sjellim materialin duhet të jetë i studiuar shumë mire kjo pjesë. Farmacitë disa kanë zgjedhur ditën pushim kurse disa të tjerë kanë zgjidhur ta kenë hapur, duhet ti zgjidhim këto të panjohura që na kanë dale, ne jemi të hapur edhe për propozime dhe të bëjmë më të mirën, pavarësisht siç tha dhe z.Kocibelli ajo është e përcaktuar edhe në kodin e punës por një biznes



familjar do të maksimizojë fitimin, sepse mendojnë që nëse e mbyll unë klienti do kalojë tek dyqani tjetër prandaj kërkojnë vendimin e këshillit bashkiak sepse nëse nuk zbatohet vendimi do ketë dhe masa penalizuese. Jap po ja u lexoj këtë pjesë janë anketuar 1080 subjekte nga të cilët rreth 750 subjekte kanë kërkuar ditën pushim dhe 232 domethënë është raporti 75 me 25 për pjesën e duam pushim ose jo, pastaj fillojmë me sa e duan ditën e hënë që e duan 70 subjekte, të martë 60 subjekte, të mërkurë e duan 12 subjekte, të premte 14 subjekte, të shtunë 15 subjekte pastaj të dielë 600 subjekte.

Këshilltar E.Nexhipi: Nuk ka ndonjë zgjidhje të na bihen dakort 100% njerëzit por të dhënat që ju lexuat vetë e kanë dhënë përgjigjen saktë, shumica e njerëzve kërkojnë një ditë të rregulluar pushim, patjetër është version që thotë Kristiani për kodin e punës mbase disa biznese e respektojnë bëhet fjalë për tregëtinë me pakicë të produkteve industriale dhe atyre ushqimore, furrat e bukës me sa di unë shumica ditën e diele e kanë me pak orë ose pushim fare, po që se sjellim argumenta kundër kësaj bihem në kundërshtim me të dhënat që të ka dhënë pyetësi ne nuk jemi që të detyrojmë njerëzit ta bëjnë pushim ne jemi që ta rregullojmë këtë me vendim, atë që ka kërkuar ligji me terma të përgjithshëm ne po kërkojmë ta vendosim, nuk po flasim për të vetpunësuarit sepse ata janë gati jo vetëm të sakrifikojnë ditën e dielë por të rrinë edhe gjithë natën çështja është si disiplinohet.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Unë nuk thashë që nuk bëhet por është një gjë që duhet bërë.

Këshilltar E.Nexhipi: Sa do presim?

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Derisa ti zgjidhim të gjitha pikëpyetjet.

Këshilltar E.Nexhipi: 70 % dakort është e mbyllur, 30 % do i bindet kësaj.

Këshilltar S.Dinellari: Vetëm se bindja nuk duhet të vijë me ndëshkim duhet të vijë me edukim.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Ditën pushim e do biznesi i vogël sepse biznesi i madh e ka zgjidhur këtë, sepse nuk i kemi kot këto pikëpyetje që na kanë dale.

Qytetari: Po kërkojmë ndihmën tuaj ta bëjmë me ligj sepse po të jetë me dëshirë e mbylлим ose jo nuk na ndalon njeri, është tregu i fruta perimeve me shumicë apo magazinat e shumicës nëse biznesi i vogël do e bëjë pushim edhe ky biznes do e bëjë pushim padiskutim.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me çështjen unë dëgjova disa shifra që kishin të bëjnë me sondazhet që kishin të bëjnë me biznset e vogla por ne këtu nuk kemi marrë parasysh fare interesin e konsumatorit të qytetarëve të cilët janë më shumë sesa këto biznese mos ndoshta është e nevojshme që në studimin që po bën bashkia të përfshihet dhe ky informacion për të pasur një vendimarrje më të mirë?

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Prandaj nuk e kemi sjellë materialin që të jetë i plotë.

Këshilltar E.Nexhipi: Për mua sa më shumë pyetësor të bëjmë aq më shumë vështirësohet puna.

Këshilltar A.Habip: Unë kisha për ta ngritur këtë çështje që muajin e shkuar por nuk kishte shumë kohë, e vërteta është që të gjithë ne si këshilltarë kemi marrë sinjalizime sepse ka shumë biznese që presin që të ketë një vendim në të mirë të qytetit dhe unë personalisht mendoj që do të sillte jo vetëm bizneseve një konsumim energjie unë këtu mar parasysh ata që janë të punësuar në biznesin e vogël por edhe në biznesin e madh nëse ne do lemë hapësirë midis bizneseve do kemi atë problematikë që thotë Erjoni nëse ne do disjelojmë biznesin e madh edhe supermarketet të jenë pjesë e këtij vendimi dhe çdo qytetar që ka nevojë për të blerë mallra deri ditën e shtunë mund ta marrë këtë shërbim, unë nisem edhe nga eksperiencia në rajon të gjitha janë të mbyllura ditën e diel duke disiplinuar edhe konsumatorin, ajo që unë do rekomandoja sigurisht nuk do mbyllet Korça me gjithë aktivitetet sepse Korça është një qytet turistik

mendoj që restorantet, hotelet të jenë të hapura sepse ne nuk mund të mbyllim aktivitetin turistik të Korçës, ndërsa për farmacitë të vendoset me grafik njëra ta ketë javën e parë, tjetra javën e dytë sigurisht kjo kërkon edhe bashkëpunimin me organet ligj zbatuese siç janë policia bashkiake, policia e rendit, organet tatimore që të ndjekin këtë proces.

Këshilltar E.Nexhipi: Për të mbështetur këshilltarët bashkia mund të zhvillojë një fushatë ndërgjegjësimi mediatike me postera dhe në këto të thotë bëj ditën e diel pushim.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Ky është një lloj edukimi, e ka qytetari fjalën e fundit dhe e mbyllim.

Qytetari: Nëse bëhet e diela pushim si në Greqi dhe Maqedoni do jetë shumë mire, pasi dhe biznesi ka nevojë për një ditë pushim.

Këshilltare J.Romaçka: Nëse krahasojmë standaret e jetesës të Selanikut me këtë të Korçës dhe do shohim që nuk janë njësoj, ka disa biznese që realizojnë të ardhurat e tyre vetëm të shtunën dhe të dielën.

Këshilltare S.Dinellari: Këshilli në kopetencën që ka mund të bëjë një situatë ndërgjegjësimi që njerëzit ta kuptojnë për çfarë ju duhet kjo, për të ruajtur atë orarin javor të punës sepse secili prej nesh ka nevojë për pushim por që të bëhet detyrim me një vendim nga ana e këshillit nuk mund të bëhet.

Qytetari: 700 biznese e duan pushim atëherë çfarë problemi keni ju që ta votoni?

Këshilltar L.Petri: Unë jam i mendimit që për këtë temë nuk na duhet shumë krahasimi me vendet e rajonit por duhet një studim i mirëfilltë për antropologjinë tonë dhe fare mire mund ta marrin këtë vendim besoj se është në të mire të biznesit të vogël por edhe gjithë komunitetit.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: E mbyllim këtu këtë diskutim dhe po ja lemë detyrë bashkisë të na japin një informacion.

Këshilltar L.Petri: Kam një kërkesë në lidhje me një strukturë që është drejtoria pyjore në datën 23 mars është një organizim me mbjellje fidanësh edhe me mbështetjen e bashkisë edhe një sërë institucionesh ku kanë kontribuar individë dhe biznese sa është e mundur që nga kjo strukturë ekzistuese të bëhet një përshtatje dhe të ketë një rojtari pyjesh që të kujdesen për këtë teritor ku janë mbjellë këto fidanë nga shoqëria civile sepse nëse futet bagëtia atje shkon dëm gjithë sipërmarrja. E dyta lidhet me orkestrën e harqeve sepse ende nuk ka një përgjigje sesi vajti fati i tyre është bërë një takim edhe me nënkryetaren znj.Besa Spaho edhe me këshillin e artit dhe kulturës kanë kaluar 3 muaj edhe ende nuk është kthyer një përgjigje zyrtare, kanë kaluar 3 muaj dhe instrumentistët shpërblehen me 680 lekë pa bërë prova si mund të shkatërrohet ky formacion pas 8 vitesh që kanë qënë të sukseshme dhe pse janë ende pa përgjigje?

Këshilltar E.Nexhipi: Një vendim që kemi marrë këtu në këshill kur bëmë buxhetin kemi përcaktuar Orkestrën Simfonike që ka përfshirë edhe Orkestrën e Harqeve sepse me aq njohuri sa kam unë Orkestra Simfonike ka harqe edhe instrumentat e tjerë dhe javën që vjen unë nuk kam autoritetin që tju ftoj por besoj do na vijë ftesë për koncertin e Orkestrës Simfonike pastaj kë përzgjedh drejtuesi i Orkestrës Simfonike nuk është kopetencë e jona që të gjykojmë sepse ai është specialist i fushës.

Këshilltar L.Petri: E kuptoj arsytimin e kolegut parafolës dhe unë nuk mendoj që ky është shqetësim i ngritur nga drejtuesi i Orkestrës të Harqeve dhe nga 9 instrumentistët të cilët janë lënë jashtë pa asnjë motivacion ata të jenë kundër Orkestrës Simfonike përkundrazi ne i urojmë suksese por a mundet ekzekutivi të na sigurojë kontratën e re të Orkestrës të Harqeve dhe asaj Simfonike?

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Po nëse i jeni drejtuar zyrtarisht.

Këshilltar E.Bregu: Herën e kaluar kemi kërkuar ngritjen e një komisioni të përkohshëm dhe sipas ligjit është e përcaktuar qartë pjesëmarrja nga ana e pozitës dhe opozitës dhe pritet që të vijnë propozimet e pjesëmarrësve, natyrisht që kjo bëhet siç u krijuan komisionet e përhershme me një farë konsensusi për ti dhënë rrugë kësaj çështje dhe nuk e di çfarë do bëhet me këtë kërkesë e paraqitur nga 11 këshilltarë të opozitës, kam dhe dy ankesa të cilat do i paraqes.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Tani nëse mundemi që këto ankesa ti futim rradhës tjetër që dhe këshilltarët ti kenë të lexuara, ti depozitojmë në sekretari dhe ti kemi për rradhës tjetër?

Këshilltar E.Bregu: Si të keni dëshirë.

Zvëndëskryetaria e Këshillit E.Mitre: Ju falenderoj për pjesëmarrjen, shihemi mbledhjen e rradhës.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**  
**ANA VERUSHI**

